Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

TREGU I MJALTIT

Mars 2017

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

ANALIZA E TREGUT TË MJALTIT

Prill, 2017

Parathënie

Mjalti kategorizohet si një nga produktet me një efekt jashtëzakonisht të mirë për shëndetin tonë. Përdorimi i mjaltit ka efekt shumë të dobishëm, prandaj rëndësi e madhe i është kushtuar prodhimtarisë së mjaltit vendor. Kohët e fundit në Kosovë vërehet një tendencë rritjeje në kultivimin e mjaltit dhe sektorit të bletarisë në përgjithësi.

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në ciklin e publikimit të analizave të tregut këtë radhë ka përzgjedhur analizimin e tregut të mjaltit, si një prodhim më një rëndësi të veçantë ku e paraqet një pasqyrë të përgjithshme të situatës dhe trendeve të zhvillimit të tregut të këtij produkti në Kosovë.

Kjo analizë shtjellon të dhënat e prodhimtarisë vendore, eksportit dhe importit, çmimeve të mjaltit vendor si dhe atij të importuar, madhësisë së tregut, mbështetjes, promovimit, sfidat si dhe konkluzionet finale mbi këtë analizë.

1 Tregu i mjaltit

Kosova karakterizohet me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e sektorit të bletarisë. Njësoj, sikurse relievi ashtu edhe llojllojshmëria e bimëve mjaltëdhënëse mundësojnë prodhimtari të mirë të mjaltit dhe produkteve të tjera të bletarisë. Prodhimtaria mesatare e mjaltit për periudhën '11-'15 llogaritet të jetë 1,236 tonë, ndërsa sasia mesatare e eksportuar e mjaltit në periudhën '12-'16 është 0.6 tonë. Në mënyrë që të përmbushen të gjitha nevojat për konsum, Kosova ka importuar mjaltë në sasi mesatare prej 154 tonë në të njejtën periudhë.

2 Prodhimtaria vendore

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i koshereve është rritur në vazhdimësi gjatë periudhës '11-'15 e kjo ka rezultuar me një prodhimtari të shtuar nga viti në vit. Gjatë vitit 2015 prodhimtaria vendore ka qenë 2,120 tonë, sasi e cila ka pasur rritje në krahasim me vitin 2014 gjatë të cilit sasia e prodhuar ka qenë 1,568 tonë. Gjatë kalkulimit të sasisë së prodhuar vendore të mjaltit dhe sasisë së tregtuar me vende të tjera, si vit për kalkulim është përdorur viti kalendarik.

3 Zhvillimi i tregtisë

Për ti përmbushur nevojat vendore për konsum për vitin 2016 Kosova importoi 200 tonë mjaltë. Mjalti është importuar në sasi të konsiderueshme gjatë viteve '12-'16. Sasia mesatare e mjaltit të importuar gjatë kësaj periudhe është 154 tonë.

Në vitin 2015 Kosova mbuloi nevojat vendore për konsum me shkallë të vetëmjaftueshmërisë prej 92%, kjo duke marrë parasysh prodhimtarinë vendore, eksportin, dhe importin e mjaltit. Pjesa tjetër prej 8% u plotësua nga importi.

3.1 Importi i mjaltit

Gjatë periudhës '12-'16, mjalti është importuar në vlerë totale prej 3.9 mil. €. Gjatë periudhës dy vjeçare '15-'16, vërehet një rritje e dukshme e importit të mjaltit, në krahasim me vitet paraprake. Viti 2016 shënon vitin me sasinë më të lartë të mjaltit të importuar ndër vite me 200 tonë.

Figura 1: Importi i Mjaltit '12-'16 (kg)



Burimi: MBPZHR-DAESB

Vendet nga të cilat Kosova importoi mjaltin në vitin 2016 janë: Maqedonia (52%), Sllovenia (19%), Shqipëria (15%), Kroacia (13%), dhe shtetet e tjera marrin pjesë me 1%. Vlera monetare e importit në vitin 2016 është 1.09 mil. €.

Figura 2: Sasia e importuar e mjaltit sipas shteteve '16 (kg)



Burimi: MBPZHR-DAESB

3.2 Eksporti i mjaltit

Gjatë periudhës '12-'16 Kosova ka eksportuar një sasi të vogël të mjaltit prej 3 tonë. Sasia e mjaltit që Kosova ka eksportuar ka shënuar rënie drastike pas vitit 2012, veçanërisht gjatë vitit 2015 dhe 2016 kur nuk ka pasur fare eksport. Viti 2012 ka qenë viti më i suksesshëm për eksport të mjaltit deri më sot, ndonëse vetëm 3 tonë janë eksportuar. Një ndër arsyet e mungesës së eksportit, është disponueshmëria e madhe e tregut brenda Kosovës.

Figura 3: Eksporti i Mjaltit '12-'16 (kg)



Burimi: MBPZHR-DAESB

3.3 Bilanci tregtar i mjaltit

Bilanci tregtar i mjaltit gjatë viteve '12-'16, është karakterizuar me vlerë negative të vazhdueshme. Mbulueshmëria më e lartë ka qenë në vitin 2012 me vetëm 2.3% dhe bilanc tregtar negativ prej 127 tonë. Ndërsa, viti 2016 shënon deficitin më të thellë tregtar ndër vite prej 200 tonë.

Figura 4: Bilanci tregtar i mjaltit për periudhën '12-'16



Burimi: MBPZHR-DAESB

4 Çmimet e tregut

Mjalti që gjendet në treg në Kosovë është kryesisht ai i luleve, akacies (bagremit) dhe gështenjës. Në tregun tonë mjaltin vendor mund ta gjejmë nga muaji Maj deri

në Shtator, ndërsa mjaltin e importuar mund ta gjejmë në çdo kohë në lloje të ndryshme dhe me çmime të ndryshme.

4.1 Çmimet në tregun vendor

Mjalti vendor fillon furnizimin në treg nga fundi i muajit Maj apo fillimi i muajit Qershor e vazhdon deri në muajin Nëntor. Sasia më e madhe e mjaltit shitet në këtë periudhë, e një pjesë tjetër që konsiderohet në sasi të vogël ruhet dhe shitet gjatë vitit të ardhshëm. Çmimi vendor në tregun me pakicë ishte rreth 9.73 €/kg për vitin 2016, ndërsa në tregun me shumicë çmimi ishte rreth 8.8 €/kg. Në vitin 2015, çmimi me pakicë sillet rreth 9.27 €/kg, kurse ai i shumicës 8.22 €/kg. Po ashtu, në vitin 2014, çmimet e shumicës dhe pakicës nuk patën ndonjë diferencë të madhe krahasuar me vitet e lartpërmendura. Figura e mëposhtme tregon gjendjen e çmimeve me shumicë dhe pakicë në tregun tonë për periudhën '12-'16.

Figura 5: Çmimet vendore '12-'16 (€/kg)



Burimi: MBPZHR-DAESB

4.2 Çmimet e importit

Mjalti i importuar në tregun tonë është prezent gjatë gjithë kohës, madje edhe gjatë periudhës kur mjalti vendor ka kohën e plasimit në treg. Çmimi mesatar i tregut me shumicë për mjaltin e importuar gjatë vitin 2013, ishte 6.50 €/kg, kurse çmimi i pakicës 8 €/kg. Gjatë vitit 2014, çmimi i shumicës ishte 7 €/kg, ndërsa i pakicës 7.43 €/kg, ndërsa gjatë vitit 2015 çmimet nuk kanë ndryshuar shumë krahasuar me vitet e kaluara ku çmimi i tregut me shumicë ishte 6.80 €/kg, kurse ai me pakicë 7.91 €/kg. Rritje e dukshme e çmimit të mjaltës së importuar vërehet gjatë periudhës '15-'16. Çmimi i mjaltës së importuar në tregun me pakicë në vitin 2016 ishte 9 €/kg, ndërsa në tregun me shumicë rreth 7.9 €/kg. Figura e

mëposhtme ilustron gjendjen e çmimeve të mjaltës së importuar me shumicë dhe pakicë për periudhën ’13-’16.

Figura 6: Çmimet e importit '13-'16 (€/Kg)



Burimi: MBPZHR-DAESB

4.3 Çmimet e mjaltit në disa vende të Bashkimit Evropian

Figura më poshtë paraqet çmimet e mjaltit në Kosovë krahas çmimeve të mjaltit në Austri, Bullgari, Greqi, Hungari, Republikën Çeke dhe Rumani në vitin 2015. Në këtë figurë shihet që çmimi i mjaltit në Kosovë është shumë i lartë në krahasim me shtetet e lartpërmendura, përveç Austrisë, e cila ka çmim më të lartë. Kjo është si rezultat i sasisë së ulët të prodhimit vendor dhe kostos së lartë të prodhimit.

Figura 7: Krahasimi i çmimeve të mjaltit në Kosovë me disa vende të BE-së, 2015 (€/kg)



Burimi: Eurostat dhe ASK

5 Madhësia e tregut

Numri i koshereve të bletëve në vitin 2015 ishte 157,005, apo 35% me i lartë se në vitin 2014, që do të thotë se janë 40,833 koshere më shumë. Prodhimtaria mesatare e mjaltit për një koshere në vitin 2015 ishte rreth 13.5 kg. Rritje më të dukshme të numrit të koshereve, respektivisht rritje prej 84% ka pasur në vitin 2015 krahasuar me mesataren në periudhën '12-'14.

Figura 8: Numri i koshereve të bletëve '11 –'15



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('12'13,'15); ASK- Vlerësime të ekspertëve në kuadër të LLEB '11; Regjistrimi i Bujqësisë ('14)

Numri më i madh i koshereve gjendet në regjionin e Prishtinës me 21%, pasuar nga Prizreni me 17%, Mitrovica, Peja dhe Gjakova me nga 14%, ndërsa numër më i vogël me pjesëmarrje nga 10% është në regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit.

Figura 9: Numri i koshereve të bletëve sipas regjioneve '14



Burimi: ASK –Regjistrimi i Bujqësisë ('14)

6 Mbështetja e prodhimtarisë së mjaltit

6.1 Pagesat direkte për bletari

Subvencionimi për bletë përmes pagesave direkte për herë të parë filloi në vitin 2012. Nga viti 2016, subvencionimi është rritur nga 10 € në 15 € për shoqëri bletësh (koshere), për fermerët që patën së paku 30 shoqëri bletësh (koshere), ndërsa fermerët e certifikuar për prodhimtari organike u subvencionuan në vlerë prej 20 € për shoqëri bletësh (koshere). Shpërndarja e pagesave direkte në bletari ka shënuar një rritje të dukshme gjatë periudhës '12-'15. Numri i koshereve të mbështetura financiarisht në vitin 2015 ka arritur në 112,958, në vlerë prej 1.1 mil € apo 45% më shumë sesa në vitin 2014.

Figura 10: Pagesat direkte për bletë 2012-2015, në 1000 €



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Në vitin 2015, subvencionet u janë ndarë të gjithë atyre që kanë pasur minimum 30 koshere të vendosura në maksimum 3 bletishte, ndërsa numri maksimal i koshereve për të cilat një fermer mund të përfitonte nuk ishte më kriter në këtë vit. Secila koshere është subvencionuar me nga 10 € për copë. Subvencionimi i numrit të koshereve në vitin 2015, ka pasur një shpërndarje të gjerë gjeografike. Numri më i madh i koshereve është në regjionin e Prishtinës dhe Pejës me nga 19%, pasuar nga regjioni i Mitrovicës dhe Gjakovës me nga 15%, dhe regjionet e tjera me 32%.

Figura 11: Numri i koshereve të subvencionuara sipas regjionit, në vitin 2015



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Mesatarja e koshereve në vitin 2015 për të cilat një fermer ka përfituar subvencione ishte 59, apo 5% më i lartë sesa në vitin 2014. Këtu mund të ketë ndikuar ndryshimi i kritereve për aplikim. Kjo mesatare ndryshon nga regjioni në regjion duke filluar me regjionin e Prishtinës me 55 koshere për një fermer dhe deri në 65 koshere në regjionin e Prizrenit. Përqindja e fermerëve të refuzuar në vitin 2015 ishte 5%, do të thotë më e ulët sesa në vitin 2014 që ishte 7.5%. Në vitin 2015 me përqindje më të lartë të refuzimit karakterizohet regjioni i Prishtinës me 6.9% ndërsa me përqindjen më të ulët regjioni i Mitrovicës me 3.6%.

Tabela 1: Pagesat direkte për bletë sipas regjionit, në vitin 2015

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr. i koshereve të subvencionuar	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	433	403	22,153	221,530
2	Prizren	254	244	15,866	158,660
3	Pejë	394	375	21,149	211,490
4	Mitrovicë	279	269	16,533	165,330
5	Gjakovë	277	263	16,576	165,760
6	Ferizaj	194	186	10,621	106,210
7	Gjilan	187	178	10,060	100,600
	Gjithsej	**2,018**	**1,918**	**112,958**	**1,129,580**

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

6.2 Përkrahja e bletarisë përmes masave të zhvillimit rural

Prodhimi, përpunimi dhe promovimi i mjaltit mbështetet në kuadër të masës **302 - Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve.** Objektivat e përgjithshme të kësaj mase janë krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre nëpërmjet diversifikimit, krijimi i kushteve të përshtatshme për parandalimin e shpërnguljes së popullatës së zonave rurale dhe zonave malore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Ndër objektivat specifike lidhur me sektorin e bletarisë janë rritja e të ardhurave të popullatës në zona rurale dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla, duke u bazuar në burimet lokale.

Sa i përket kritereve të veçanta të pranueshmërisë, aplikuesit në sektorin e bletarisë duhet të kenë së paku 50 shoqëri (koshere) bletësh. Investimet e pranueshme për prodhimin, përpunimin dhe promovimin e mjaltit janë: blerja e koshereve, blerja e makinerisë dhe pajisjeve për prodhimin dhe përpunimin e mjaltit, rimorkio të specializuara për bartjen e koshereve, vetëm për aplikuesit me mbi 80 koshere, investimet në pajisje për nxjerrjen e produkteve të bletës, investimet në pajisje për kultivimin e mëmave, ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i dhomës së mjaltit, blerja e pajisjeve laboratorike për analizimin e produkteve të bletëve, blerja e linjave teknologjike për mbushje dhe paketim të mjaltit, dhe blerja e pajisjeve për energji të ripërtërishme. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme brenda kësaj mase është 5,000 € ndërsa vlera maskimale 30,000 €.

Përkrahja publike është 65% e shpenzimeve të pranueshme të investimit ndërsa përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore. Ndarja e planifikuar buxhetore në vitin 2017 për prodhimin, përpunimin dhe promovimin e mjaltit është 500,000 € apo 33% e buxhetit të kësaj nënmase.

7. Konkluzione

Kosova ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë të tilla si klima, relievi dhe numri i madh i bimëve mjaltëdhënëse (më shumë se 164 lloje) që garantojnë një prodhim të mirë të mjaltit dhe produkteve të bletarisë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural është duke i dhënë mjaft rëndësi këtij sektori i cili ka mjaft potencial dhe është i rëndësishëm për Kosovën. Mbështetja e këtij sektori përmes pagesave direkte ka shënuar rritje të vazhdueshme dhe meqenëse ky sektor është mbështetur me vite, si rezultat i kësaj numri i koshereve nga viti 2011 deri në vitin 2015 është katërfishuar.

Përveç mbështetjes financiare e cila është rritur vazhdimisht dhe pritet të rritet ende në vitet në vijim, MAFRD-ja po ashtu ju ofron lehtësime bletarëve sa i përket prodhimit, përpunimit, dhe marketingut të mjaltit. Sa i përket kritereve për aplikim, MAFRD është duke i lehtësuar kriteret ashtu që të mundësohet rezultat sa më i mirë i kësaj mbështetje, dhe në bashkëpunim me bletarët, janë duke u diskutuar vazhdimisht sfidat e tyre në mënyrë që të krijohen politika sa më të avancuara për zhvillimin e këtij sektori.

Meqenëse në Kosovë ekziston kërkesë mjaft e madhe për mjaltin, paraqitet nevoja për të ofruar trajnime të avancuara dhe shërbime këshilluese për fermerët në mënyrë që të rritet sa më shume specializimi në këtë fushë. Mjalti dhe produktet e tjera të bletarisë, gjithmonë duke iu referuar potencialeve të prodhimit janë produkte me potencial që krijojnë mundësi për zhvillimin e bizneseve të qëndrueshme.